



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:069719

Datë: 25.09.2023

Numri i dokumentit: 04716201

SCC-11-0276

Paditësi

K B I – Gjakovë.
Të cilin e përfaqëson Av. T B, Gjakovë
Kundër

Të paditura

1. **K Gj** - Gjakovë
2. **KBI “Ereniku”**– Gjakovë, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Hajrie Shala gjyqtarë, pas vendimmarrëse të mbajtur me 25 shtator 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

1. **Padia e paditësit hedhet poshtë.**
2. **Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 07 dhjetor 2011, paditësi ka parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS) kundër të paditurave për vërtetimin e drejtës se pronësisë dhe kthimin në

posedim të ngastrës kadastral numër 206/1 ZK- Gjakovë. Ka theksuar se paditësi ka qenë pronar i ngastrës në fjalë, por që në vitin 1955 me reambullim zona kadastrale Gjakovë-qytet, ngastra nr. 206, pëson ndryshime ashtu që kjo ngastra 206 ndahet në ngastrën nr. 206/1 në emër të sekretariatit të Punëve të Brendshme, ndërsa ngastra nr. 206/2 mbetet në emër të K B I në Gjakovë. Ka shtuar se në vitin 1988 sipas regjistrimit të ndërrimeve nr. 72/88, në bazë të aneksit të kontratës leg. Nr. 04-404-951, parcela kadastrale nr. 206/1 e tëra kalon me fletën posedues nr. 1474 në posedim të KBI Ereniku – Gjakovë. I ka propozuara Gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar.

Me 08 dhjetor 2014, e paditura KBI - Ereniku e përfaqësuar nga AKP-ja, ka paraqitur mbroje në padi dhe e ka kundërshtuara në tërësi padinë dhe pretendimet e paditësit si të pa pabazuara në ligj. Ka shtuara se e nuk ka kurrfarë raporti juridik me paditësin për faktin se prona kontestuese ka kaluar në emër të NSH-së mbi bazën e punës së vlefshëm juridike. Ka shtuara se paditësja nuk ka paraqitur prova në kuptim të nenit 37 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore –Pronësore Juridike dhe gjithashtu nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të LPK-së. I ka propozuara Gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Me 05 janar 2015, Gjykata me urdhër e ka dërguar mbrojtjen në padi të i paditësi B I – Gjakove.

Me 16 maj 2023, gjykata ka mbajtur seancë dëgjimore, ku palët kanë paraqitur pretendimet e tyre, mirëpo seanca është shtyre me kërkesën e përfaqësuesit të paditësit, në mënyrë që ai ta precizoj padinë në aspektin objektiv brenda afatit prej 30 ditësh.

Me 19 maj 2023, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur një parashtresë, përmes së cilës ka kërkuara nga të paditurat që të prezantojnë të gjitha provat materiale lidhur me ngastrën kontestuese.

Me 28 korrik 2023, gjykata i ka dozuar parashtresën e paditësit tek të paditurat për përgjigje.

Me 03 gusht 2023, e paditura-AKP, ka dorëzuar përgjigje në urdhër.

Me 17 gusht 2023, gjykata me urdhër i ka ftuar palët në seancë dëgjimore për dt. 21 shtator 2023. Me urdhër për seance gjykata i ka dërguara përgjigjen e AKP-së të dt. 03 gusht 2023 tek paditësi.

Me 21 shtator 2023, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i palës së paditur- AKP-së, ndërsa nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit dhe as e paditura Komuna e Gjakovës edhe pse kanë qenë i ftuar në mënyrë të rregullt. Gjykata priti përfaqësuesin e paditësit dhe K Gj 10 minuta në sallën e gjykimit por ata nuk u paraqiten. Përfaqësuesi i të paditurës së parë AKP, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Pas orës 13:30, gjykata është informuara nga zyra e regjistrimit në lidhje me dy parashtresa të dt. 20 shtator 2023, të cilat i kishte dorëzuar përfaqësuesi i paditësit ku ndër të tjera ka zgjeruar kërkesë padinë e tij si dhe ka njoftuar gjykatën që për arsye objektive nuk ka mundësi të asistoj në seancë ashtu që i ka propozuar gjykatës që seanca të mbahet në mungesën e tij.

Për detaje tjera referimi bëhet tek shkresat e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjësis mund, pas parashtrimi të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 21 shtator 2023, në ora 09:30, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Gjykata ka pritur përfaqësuesin e paditësit dhe të paditurën e parë K Gj në sallën e gjyqimit për 10 minuta, mirëpo ata nuk u paraqiten në seancë. Përfaqësuesi i të paditurës – AKP, i propozoj gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata konstaton se përfaqësuesi i paditësit dhe e paditura e parë janë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar. Ftesat për seancën ju kanë dorëzua të njëjtëve 29 ditë para seancës dëgjimore. Gjykata vlerëson se të njëjtit kanë pasur kohë të mjaftuara për tu paraqitur në seancë. Gjykata po ashtu nënvizon se edhe përfaqësuesi i paditësit përmes parashtrësës së dt. 20 shtator 2023 i ka propozuara gjykatës që të mbaj seancë dëgjimore në mungesë tij, andaj duke pasur parasysh edhe kërkesën e përfaqësuesit të paditurës – AKP, që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykim të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Hajrie Shala, Gjyqtare